



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR  
PËR VITIN 2023**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke Vlerësuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;
- Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe rëmërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;
- Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;
- Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;
- Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor;

**Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2023, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konstaton:**

- Zhvillimin e 80 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 743 vendimeve (24% më shumë se 1 vit më parë), nga të cilat 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregulla të brendshëm dhe 1 udhëzim.
- Implementimin dhe zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, përmes hartimit të një pakete prej 60 aktesh administrative dhe individuale.
- Plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë me 19 anëtarë, përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magistratëve.
- Unifikimin e standardeve të administrimit të brendshëm gjyqësor përmes miratimit të rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata.
- Miratimin e kuotave për ndihmës ligjorë dhe magistratë “profili gjyqtar” për vitin akademik 2023- 2024 në Shkollën e Magjistraturës.
- Zhvillimin dhe përfundimin e procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë.
- Verifikimin dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor për 4 nëpunës civilë gjyqësorë, 3 ndihmës ligjorë në njësinë e shërbimit ligjor në gjykata e apeleve dhe 1 këshilltar ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
- Emërimin e 41 magistratëve, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023.
- Verifikimin e kriterëve dhe kushteve formalo-ligjore, si dhe të pasurisë dhe figurës për 46 kandidatë.
- Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, me qëllim vetëpastrimin e sistemit gjyqësor duke zhvilluar 6 procedime disiplinore.
- Plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, duke trajtuar përkatësisht 169 kërkesa, dhe caktuar 208 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si dhe duke përfshirë në skemë delegimi 5 gjyqtarë dhe transferuar 33 gjyqtarë.
- Vazhdimin e vlerësimeve etike-profesionale të gjyqtarëve, duke hartuar dhe miratuar 57 raporte vlerësimi. Në periudhën 4-vjeçare janë vlerësuar vetëm rreth 37% të gjyqtarëve që ndodhen efektivisht në detyrë.
- Vijimin e angazhimit në funksion të rritjes së transparencës dhe eficiencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.
- Përfundimin e digjitalizimit të arkivës për 8 nga 20 gjykata që ka aktualisht.
- Miratimin e udhëzuesit standard si dhe rritjen e numrit të gjyqtarëve të medias nga 8 në 17 të tillë, që mbulojnë juridiksionin e përgjithshëm dhe posaçëm për të dyja nivelet e gjykimit.
- Rritjen e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe stafin administrativ, nëpërmjet trajnimit të 209 gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën, 103 nëpunës civilë gjyqësorë dhe 15 punonjës të KLGJ-së, në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, projektet e asistencës së huaj dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

**Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:**

1. Të vijojnë me prioritet procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. Brenda muajit dhjetor 2024 të informojë Kuvendin me të dhëna statistikore mbi performancën e sistemit gjyqësor pas zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, si dhe për problematikat në lidhje me të.
3. Të vazhdojë puna për hartimin dhe miratimin e kuadrit nënligjor për planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, veprimtarinë dhe mirëfunksionimin e gjykatave si dhe për mirëfunksionimin e administratës civile gjyqësore në zbatim të reformës për nëpunësin civil gjyqësor.
4. Të hartojë dhe të miratojë aktet për përcaktimin e standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve
5. Të përshpejtojë procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
6. Të vijojë nxitja e Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikave gjyqësore, me qëllim vendosjen e standardeve të njëjta në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut në procesin penal, parimit të proporcionalitetit veçanërisht për zbatimin e masave të sigurimit personal, aplikimin e gjyqësorëve të posaçme dhe veprave penale të dhunës në familje.
7. Të vijojë puna për trajtimin me prioritet të procesit të vlerësimeve etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me programin e miratuar si dhe të paraqesë në shtator 2024, në mënyrë të strukturuar tabelare bilancin e vlerësimeve të kryera si dhe evidenca progresive për të gjithë trupën subjekt vlerësimi, si dhe kohën që ka marrë përfundimi i secilit vlerësim nga institucioni.
8. Të ndërmerë angazhime konkrete, për sa i takon Këshillit bazuar në kompetencat e tij ligjore dhe të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër ngritjen dhe bërjen funksional të sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të përmbushur detyrimin ligjor, si dhe të njoftojë periodikisht Kuvendin për ecurinë dhe problematikat.
9. Të vijojë me digjitalizimin e arkivave të gjykatave në mënyrë progresive dhe të shpejtë, për të përmirësuar shërbimet publike në gjyqësor deri në ofrimin e tyre në kohë reale.
10. Të marrë masa për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
11. Të vijojë me dhënien e kontributit në adresimin e problematikave të konstatuara në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2023 lidhur me aktivitetin e Këshillit.
12. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

